



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrasnjih Poslova
/Ministry of Internal Affairs
Agjencia e Menaxhimit Emergjent/Agencija Emergentnog Upravljanja
/Emergency Management Agency

STRATEGJIA PËR ZVOGËLIM TË RREZIKUT NGA FATKEQËSITË DHE PLANI I VEPRIMIT 2016 - 2020

MESAZH NGA MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

SZRrF ka për qëllim zvogëlimin e rreziqeve ekzistuese dhe parandalimin e rreziqeve të reja, fuqizimin e qëndrueshmërisë, duke përfshirë përgjegjësinë primare të shtetit për të parandaluar dhe zvogëluar rrezikun nga fatkeqësitë, angazhimin e tërë shoqërisë dhe institucioneve shtetërore. Fushëveprimi i SZRrF nga fatkeqësitë është zgjeruar në mënyrë të konsiderueshme dhe fokusohet në rreziqet natyrore dhe rreziqet e ndërlidhura mjedisore e teknologjike.

Fatkeqësitë, natyrore dhe ato teknologjike janë duke u rritur në shpeshtësi dhe intensitet, pengojnë në mënyrë të konsiderueshme progresin drejt zhvillimit të qëndrueshëm duke gjeneruar rreziqe të reja, rritje të humbjet e ndërlidhura me fatkeqësitë, të cilat kanë ndikim ekonomik, social, shëndetësor, kulturor dhe mjedisor. Faktet tregojnë se ekspozimi i personave dhe pasurive, në të gjitha vendet, është rritur më shpejtë se që është zvogëluar cenueshmëria në tërësi.

SZRrF është strategji multi-sektoriale, gjithëpërfshirëse, e arritshme, efikase dhe efektive, që ka qëllim zvogëlimin e rreziqeve nga FNFT. Për të kuptuar këtë duhet të ngritim njohuritë e menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë për zyrtarët qeveritarë në të gjitha nivelet, shoqëritë civile, komunitete dhe vullnetarë, si dhe sektorin privat, përmes shkëmbimit të përvojave, mësimave të fituara, praktikave të mira dhe trajnimit dhe edukimit mbi zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë, duke përfshirë përdorimin e mekanizmave ekzistues të trajnimit, edukimit dhe mësimimit të ndërsjellë.

Bashkëpunimi ndërkombëtar, rajonal, ndër-rajonal dhe ndërkufitar mbetet i rëndësishëm në mbështetjen e përpjekjeve të shteteve, autoriteteve të tyre kombëtare dhe lokale, si dhe komuniteteve dhe bizneseve, në zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë.

Duke pasur parasysh këtë dhe në mënyrë që të zvogëlohet rreziku nga fatkeqësitë, ekziston nevoja për adresimin e sfidave ekzistuese dhe përgatitjes për sfidat në të ardhmen, duke u fokusuar në monitorimin, vlerësimin dhe të kuptuarit e rrezikut nga fatkeqësitë dhe shkëmbimin e informacioneve të tilla dhe mbi atë se si është krijuar fuqizimi i menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë dhe koordinimi i të gjitha institucioneve dhe sektorëve përkatës dhe pjesëmarrja e plotë dhe kuptimplotë e akterëve në nivelet e duhura.

Parandalimi i rreziqeve të reja dhe zvogëlimi i rreziqeve të tanishme nga fatkeqësitë përmes zbatimit të masave të integruara dhe gjithëpërfshirës e ekonomike, strukturore, ligjore, sociale, shëndetësore, kulturore, arsimore, mjedisore, teknologjike, politike dhe institucionale të cilat parandalojnë dhe zvogëlojnë ekspozimin dhe cenueshmërinë e rrezikut ndaj fatkeqësive, rrisin gatishmërinë për reagim dhe rimëkëmbje dhe në këtë mënyrë fuqizojnë qëndrueshmërinë.

Republika e Kosovës si shtet i ri në zhvillim ka nevojë për rritje të mbështetjes së koordinuar, të qëndrueshme dhe adekuate ndërkombëtare për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë, duke ditur përballjen me sfida të veçanta për zhvillimin dhe forcimin e kapaciteteve vendore të parandalimit, përgatitjes, rehabilitimit dhe rimëkëmbjes, andaj bashkëpunimi ndërkombëtar, rajonal dhe ndërkufitar mbetet i rëndësishëm për mbështetjen e përpjekjeve të autoriteteve të pushtetit qendror dhe lokal, si dhe komuniteteve dhe bizneseve, në zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë.

Për këtë arsye institucionet e Republikës së Kosovës duhet të bashkëpunojnë me institucionet financiare ndërkombëtare, si bankat botërore dhe bankat rajonale, për zhvillim, si dhe duhet të analizojnë objektivat e kësaj strategjie për ofrimin e mbështetjes financiare dhe kredive për zvogëlimin e integruar të rrezikut nga fatkeqësitë në vend.

Zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë është një investim me kosto-efektive në parandalimin e humbjeve të ardhshme. Menaxhimi efikas i rrezikut nga fatkeqësitë kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm. Vendi duhet të përmirësojë kapacitetet e veta në menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë.

Institucionet e Republikës së Kosovës dhe juridiksionet tjera në nivel qendror dhe lokal do të jenë kryesisht përgjegjëse për implementimin e SZRRF.

**Ministri i Punëve të Brendshme i Republikës së Kosovës
Prishtinë, Maj 2016**

PËRMBAJTJA:

Lista e shkurtesave	6
Përmbledhje ekzekutive	7
Hyrje.....	8
Kapitulli I: Metodologjia.....	10
Kapitulli II: Sfondi	11
Kapitulli III: Kuadri Strategjik.....	20
KUADRI STRATEGJIK.....	20
Misioni	20
Objektivat.....	20
3.1. Objektivat strategjike dhe Masat e ndërmarra	20
Kapitulli IV: Alternativat e konsideruara	25
Kapitulli V: Korniza ligjore dhe institucionale	26
Kapitulli VI: Monitorimi dhe vlerësimi	33
Bibliografia.....	36
Qëllimi i Planit të Veprimit për SZRRF	38

LISTA E SHKURTESAVE

AME	Agjencia e Menaxhimit Emergjent
CEFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë për Evropën Qendrore
DPPA	Deklarata e Politikave Prioritare Afatmesme
DPPA	Deklarata e Politikave Prioritare Afatmesme
FNFT	Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera
FSK	Forcat e Sigurisë së Kosovës
HFA	Korniza e Hyogos për Veprim
IHK	Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës
IPA	Instrumenti i Para Aksesimit
KKK	Kryqi i Kuq i Kosovës
MAP	Ministria e Administratës Publike
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MF	Ministria e Financave
MI	Ministria e Infrastrukturës
MKK	Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqënies Sociale
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MIE	Ministria e Integritimit Evropian
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
NJPZSH	Njësitë Speciale për Zjarrfikje dhe Shpëtim
OBT	Organizata Botërore e Tregtisë
PLANAT	Platforma Kombëtare për Fatkeqësitë Natyrore
SFA	Korniza e Senday-it për Veprim
SIME	Sistemi i Integruar i Menaxhimit Emergjent
SMSHN	Strukturat për Mbrojtje, Shpëtim dhe Ndihmë
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNICEF	Fondi i Emergjencës së Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UNISDR	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Zvogëlim të Rrezikut nga Fatkeqësitë
ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZRrF	Zvogëlimi i Rrezikut nga Fatkeqësitë

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Fatkeqësitë natyrore në Kosovë përbëjnë një rrezik për jetën, pasurinë, ambientin dhe trashëgiminë kulturore të qytetarëve. Në fakt në tërësi procesi i zhvillimit ekonomik dhe social i vendit është i cenuar nga rreziqet e fatkeqësive natyrore, të cilat shpesh i kushtojnë miliona euro ekonomisë, si dhe në veçanti prekin komunitetet në nevojë. Duke qenë një shtet i ri, Kosova ende nuk ka ngritur kapacitete të plota për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore në të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit emergjent. Kjo strategji që përfshin periudhën 2016 - 2020 është një dokument themelor që ka për qëllim të bashkërendojë punën nga akterët në nivel lokal, ministritë e linjës si dhe donatorët vendorë dhe të huaj, për të zvogëluar rrezikun nga fatkeqësitë dhe njëkohësisht duke kontribuar në zhvillim të qëndrueshëm të Kosovës. Ky dokument është strategjia e parë për zvogëlimin e rrezikut për Republikën e Kosovës dhe si e tillë do shërbejë si një themel mbi të cilin do ndërtohet programi për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe do të bashkërendohen aktivitetet për vite me radhë.

Objektivat kryesorë të kësaj strategjie (2016 - 2020) janë:

- Integrimi i Zvogëlimit të Rrezikut në politika dhe plane zhvillimore, si dhe mbikëqyrja;
- Fuqizimi i kapaciteteve për menaxhimin e rreziqeve nga FNFT;
- Krijimi i komuniteteve të sigurta dhe të qëndrueshme nga fatkeqësitë;
- Vetëdijësimi dhe nxitja e institucioneve dhe subjekteve për rreziqet nga FNFT.

Vlerë e shtuar e strategjisë do të jetë që për herë të parë Kosova do ketë një dokument të vetëm ku përfshihen të gjitha fushat që lidhen me zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe teknologjike. Strategjia gjithashtu është në përputhje me standardet ndërkombëtare. Për më tepër objektivat e saj janë në linjë me Kornizën e Senday-it për Veprim, si dhe Strategjisë Evropiane për Mbështetjen e Zvogëlimit të Rrezikut nga Fatkeqësitë në vendet në Zhvillim (2009). Strategjia e ZRRF ndërlidhet me Deklaratën e Politikave Prioritare Afatmesme (DPPA) të Qeverisë së Republikës së Kosovës për 2014 – 2016, që përcakton kornizën e politikave dhe projekteve të cilat planifikon t'i zbatojë gjatë periudhës së ardhshme afatmesme 2014-2016 Kapitulli 2, "Qeverisja e mirë"; pika 3.2, fuqizimi dhe zbatimi i ligjit "Menaxhimi i situatave emergjente, do të vazhdohet me politikat ekzistuese: ngritjen e aftësisë vepruese."¹

Për të qenë në harmoni me përpjekjet globale dhe kërkesat të cilat shtrohen nga ana e bashkësisë ndërkombëtare dhe Komisionit Evropian, si përpjekje globale në kuadër të programit të Kombeve të Bashkuara për Zvogëlimin e Rreziqeve nga Fatkeqësitë dhe Ngrohjen Globale.

Kapitujt pasardhës do të fokusohen tek çështjet kryesore që çojnë në vendimin e përcaktimit të ndërhyrjeve për zvogëlimin e rrezikut në Kosovë. Kapitulli i parë shtjellon metodologjinë e përdorur për hartimin e kësaj strategjie. Kapitulli i dytë përshkruan profilin e fatkeqësive në Kosovë duke përcaktuar problemet themelore që adreson ky dokument. Kapitulli i tretë përmban prioritetet e kësaj strategjie duke filluar nga vizioni, misioni, objektivat strategjike dhe masat me të cilat do të matet suksesi i kësaj strategjie. Kapitulli i katërt dhe i pestë hulumtojnë, diskutojnë dhe kërkojnë zgjidhjet alternative, si edhe kontekstin ligjor dhe institucional në të cilin bazohet strategjia. Kapitulli i gjashtë shtjellon dhe nënvizon politikat që rrjedhin nga kjo strategji të përfshira në planin e veprimit ku reflektohen aktivitetet, detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve përkatëse, indikatorët matës, afatet kohore dhe koston. Së fundmi kapitulli i shtatë shpalos kriteret për monitorimin dhe vlerësimin për të siguruar zbatimin e suksesshëm të Strategjisë për ZRRF.

¹ Qeveria e Kosovës, 2013, Deklarata e Politikave Prioritare Afatmesme 2014-2016.

HYRJE

Pas deklarimit të Pavarësisë, më 17 shkurt 2008, Republika e Kosovës ka marrë "obligimet e anëtarësisë së përgjegjshme në bashkësinë ndërkombëtare" dhe ka pranuar që "t'i përmbahet parimeve të Kartës së Kombeve të Bashkuara, Aktit Final të Helsinkit, akteve të tjera të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, obligimeve ligjore ndërkombëtare dhe parimeve të marrëdhënieve të mira ndërkombëtare, që shënojnë marrëdhëniet ndërmjet shteteve".

Kosova ka arritur progres në shumë fusha të zhvillimit të saj si në: stabilitetin politik dhe ekonomik, plotësim të legjislationit, në ngritjen e infrastrukturës së sigurisë dhe kapaciteteve për menaxhim emergjent duke u shëndrruar në faktor stabiliteti në rajon.

Bazuar në Ligjin për AME ² Agjencia e Menaxhimit Emergjent (AME) /MPB, është institucioni kryesor përgjegjës për koordinimin dhe menaxhimin e situatave emergjente dhe Zvogëlimin e Rreziqeve nga Fatkeqësitë (ZRrF), e cila koordinon dhe bashkëpunon ngushtë me institucionet e nivelit qendror dhe lokal, OJQ-të, shoqërinë civile, sektorin privat, etj.

Kosova tashmë është bërë pjesë e integritimeve ekonomike në rajon, me synim për zgjerim të tregut edhe më gjerë. Qëllim në vete tashmë është rritja e konkurrueshmërisë së kësaj ekonomie duke rritur kapacitetin e saj eksportues për të zvogëluar deficitin tregtar që Kosova aktualisht ka. Si vend i rëndësishëm për zhvillimin e biznesit Kosova ofron një sërë përparësish komparative si: popullsinë me moshë të re dhe mjaftë mirë të kualifikuar, resurse të konsiderueshme natyrore, me kushte të volitshme klimatike, infrastrukturë të re, pozita gjeografike me qasje në tregun rajonal të CEFTA-s dhe në atë të Bashkimit Evropian, vend që aspiron në mekanizmat etjerë të fuqishëm ekonomik-financiar, si Organizata Botërore e Tregtisë- OBT-së, etj.

Kosova ka një trashëgimi kulturore të pasur që nga qytetërimet antike e deri më sot, që trashëgon një thesar të pasur kulturor, e cila është pjesë integrale e trashëgimisë kulturore botërore. Kjo trashëgimi e pasur, gjendet në çdo pjesë të Kosovës, në: parqet e qendrat arkeologjike e natyrore, në galeritë e artit, arkivat fotografike e filmike, në kalatë dhe kullat, në monumentet e kultit dhe vendbanime, në kalldrëmet e rrugicat e ngushta, në shatërvanët si edhe në muzetë e saj, koleksione të artefakteve, punime artizanale, etj.

Institucione qendrore dhe organizma të tjerë relevantë në nivel shtetëror të cilat janë konsultuar ngushtë për këtë strategji përfshijnë: Zyrën e Kryeministrit (ZKM), Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Instituti Hidro-meteorologjik i Kosovës (IHK), Kryqi i Kuq i Kosovës (KKK), Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), Ministrinë e Shëndetësisë (MSH), Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik (MZHE), Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe Zyra e Kombeve të Bashkuara për Zvogëlim të Rrezikut nga Fatkeqësitë (UNISDR), Fondi Emergjent i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë (UNICEF), Sektori Privat, Aleanca e Biznesit, etj.

Situatat emergjente të shkaktuara nga FNFT ose nga zhvillimi i aktiviteteve të faktorit njeri çdo ditë rrezikojnë jetën e njerëzve, si dhe shkaktojnë humbje në të mira materiale. Rreziku nga fatkeqësitë ekziston në çdo shoqëri nga se fatkeqësitë ndikojnë në zvogëlimin e trendëve të zhvillimeve të shoqërisë në aspekt të përgjithshëm ndërsa paraqitja e tyre në ndonjë vend mund të shkaktojë

² Ligji për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent, Nr. 2004/ 04/L-230.

humbje jo vetëm në vendin e përfshirë në fatkeqësi por edhe më gjerë. Gërshetimi i faktorëve të lartcekur kërkon hartimin e një Dokumenti-Plani Strategjik Kombëtar, në nivel vendi për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe të gatishmërisë për një reagim më të mirë në Republikën e Kosovës e cila përfshin fazën e parandalimit, gadishmërisë, reagimit dhe rimëkëmbjes.

Kjo strategji që përfshinë periudhën 2016 - 2020 ndërlidhet ngushtë me objektivin e mëposhtëm të Qeverisë së Kosovës sa i përket fatkeqësive natyrore³:

- Objektivat e veçantë në fushën e përballimit të emergjencave civile.
- Kryerja e studimeve të veçanta me qëllim të parandalimit të emergjencave nga fatkeqësitë natyrore, si dhe përgatitja dhe avancimi i përsosjes së mënyrës së reagimit të kapaciteteve civile.

Baza e Strategjisë për SZRRF gjendet në Ligjin nr. 04/-L-027 për FNFT, UA 02/2012, si dhe Dokumentin e Vlerësimit të Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera i cili është hartuar në bazë të Rregullores nr. 28/2012.

Strategjia për ZRRF (2016 - 2020) është edhe në harmoni me dokumentet tjera kombëtare dhe ndërkombëtare siç janë: dokumenti Strategjik i Republikës së Kosovës: Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave (SIME), Strategjia për Siguri, Strategjia për Ndryshime Klimatike 2014-2020, Synimet e Qëndrueshme për Zhvillim, të definuara sipas Kombeve të Bashkuara dhe në kuadër të Kornizës së Senday-it për Veprim për vitet 2015-2030: Zhvillimi i qëndrueshmërisë kombëtare dhe komuniteti në fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi tjera, etj. Përveç tyre me rastin e ndërtimit të Strategjisë Nacionale, është marrë në konsideratë edhe Strategjia e Bashkimit Evropian për Sigurinë e Brendshme dhe Strategjia Evropiane për mbështetje në zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore të vendeve në zhvillim⁴. Strategjia për ZRRF do të shërbejë edhe si udhërrëfyes i Kosovës për anëtarësim në "Forumit Evropian për Zvogëlim të rrezikut nga Fatkeqësitë."

³ Qeveria e Kosovës, 2013, Programi I Qeverisë së Republikës së Kosovës 2015-2018, http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/programi_i_qeverise_shqip_pdf_, qasja më 11 Dhjetor 2015

⁴ UNISDR, Preventionweb, <http://www.preventionweb.net/ipadrr/>, qasja më 11 Dhjetor 2015.

KAPITULLI I:

METODOLOGJIA

Për hartimin e Strategjisë së ZRRF-së, Kosova ka pasur mbështetjen nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), si dhe është konsultuar me ekspertë profesional të Platformës Kombëtare për Fatkeqësitë Natyrore (PLANAT) të Konfederatës Zvicrane duke përfituar nga praktikat më të mira, si dhe janë realizuar vizita studimore/ shkëmbim përvojash.

Me vendimin 05/10, më 29.10.2014, Kryeshefi i Agjencisë së Menaxhimit Emergjent ka aprovuar krijimin e grupit punues për hartimin e strategjisë me përfaqësues nga: Agjencia e Menaxhimit Emergjent/Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra e Kryeministrit, Ministria e Pushtetit Lokal, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Integritimit Evropian, ndërsa në cilësinë e ekspertëve janë zyrtarë nga UNDP dhe këshilli ndërministror për ujëra. Duke synuar një qasje multidisiplinare për zvogëlimin e rreziqeve dhe integrimin e këtyre fenomeneve në politikat dhe planet zhvillimore në vend, grupi punues pas seminarit tre ditorë është takuar rregullisht në baza mujore për mbikëqyrjen e progresit dhe planifikimin e hapave të mëtejme. Janë konsultuar edhe ministritë dhe institucionet tjera përkatëse të cilat nuk janë anëtarë të grupit punues siç janë: Ministria e Shëndetësisë, Agjencia eUshqimit dhe Veterinarisë, Agjencia për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore, etj. në mënyrë që strategjia të jetë sa më gjithëpërfshirëse dhe kuptimplotë.

Grupi i ekspertëve nga PLANAT gjithnjë, në faza të ndryshme të zhvillimit të strategjisë ka ofruar konsulencë për përmbajtjen e strategjisë. Së fundmi, disa fenomene sikurse janë ndryshimet klimatike, jonizimi dhe vërshimet nuk trajtohen në këtë strategji pasi mbulohen nga strategjitë përkatëse sektoriale.

KAPITULLI II:

SFONDI

2.4.1. Problemi

Kjo Strategji trajton në veçanti çështjen e Zvogëlimit të Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Teknologjike. Kosova ka një ekspozim dhe cënueshmëri të konsiderueshme ndaj fatkeqësive natyrore dhe teknologjike. Në territorin e Kosovës veçohen këto zona të burimeve sizmike: Ferizaj-Viti-Gjilan, Skenderaj, Mitrovicë, Pejë-Gjakovë- Prizren- Dragash dhe Kopaonik. Vlerat më të larta të magnitudës maksimale të pritshme janë: Ferizaj-Viti-Gjilan (6.5), Skenderaj (5.0), Mitrovicë (5.0), Pejë-Gjakovë-Prizren- Dragash (6.6) dhe Kopaonik (6.0).⁵

Tërmeti i fundit në Istog me shkallë më të lartë të goditjes ka ndodhur në vitin 2010 në pjesën perëndimore të vendit dhe arriti 5.2 Rihter. Në Prill 2002 Gjilani u prek nga një tërmet prej 5.7 ballë nga i cili u shkaktoan dëme të konsiderueshme në infrastrukturë dhe të mira materiale. Sipas Institutit të Sizmologjisë, rreth 10 tërmete me intensitet të ulët regjistroheshin çdo ditë në vend.⁶

Fatkeqësitë natyrore që godasin dhe rrezikojnë më së shpeshti Kosovën janë: vërshimet, zjarret, gjeologjike, biologjike dhe ngjarjet meteorologjike. Databaza e fundit me të dhëna historike e cila është krijuar në vitin 2015 "DesInventar Kosova"⁷ pasqyron rreziqet kryesore nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësi të tjera në Kosovë. Në total sipas gjetjeve të DesInventar çdo vit mesatarisht preken 14400 njerëz nga fatkeqësitë, rreth 1÷2 persona humbin jetën, ndërsa dëmet ekonomike mbërrijnë deri në 8.5 milion (€) me 1228 shtëpi dhe 1261 hektarë tokëtë goditura nga fatkeqësitë. Sipas fatkeqësive natyrore Kosova goditet si vijon: zjarret pyjore (74 %), kryesisht në Prishtinë, Kamenicë dhe Deçan; përmbytjet dhe vërshimet (82%), kryesisht në Ferizaj, Rahovec dhe Skënderaj. Ngjarjet meteorologjike (39%) me theks të veçantë në: Podujevë, Ferizaj dhe Gjakovë. Fatkeqësitë natyrore konsiderohen si fenomene që mund të afektojnë në sigurinë dhe shtetin ligjor.⁸ Duke konsideruar nivelin e ulët të zhvillimit shoqëror, ekonomik, si edhe problemet mjedisore që janë në rritje, rreziku nga fatkeqësitë natyrore në Kosovë llogaritet të ketë dëme të konsiderueshme në zhvillimin socio-ekonomik.⁹

⁵ Qeveria e Kosovës, 2009, Vlerësimi i Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësi të tjera.

⁶ Zupka, 2011, Raport i Vlerësimit të Kapaciteteve për ZRRF


⁷ Agjencia e Menaxhimit Emergjent, 2015, DesInventarKosova, <http://desinventar.cimafoundation.org/DesInventar/profiletab.jsp?countrycode=rks&continue=y>, qasja më 11 Dhjetor 2015

⁸ Qeveria e Kosovës, 2014, Analiza e Sektorit Strategjik të Sigurisë.

⁹ Zupka, 2014, Integrimi i Zvogëlimit të Rrezikut për Investime.


2.4.2. Historiku i zhvillimit të rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe teknologjike

Përpjekja për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore në Kosovë sikurse edhe në botë, është një problem i cili është përkeqësuar në 15 vitet e fundit të tranzicionit, kjo për shkak të fenomenit të ndryshimeve klimatike, industrializimit të vendit, dëmeve të shkaktuara nga lufta, vendbanimet jo-formale, mungesën e planeve dhe moszbatimi i masave për ruajtjen e mjedisit, degradimi i pyjeve dhe shtretërve të lumenjve, deponimit të mbeturinave. Duke u bazuar në statistikat e dhëna nga DesInventar-i¹⁰ numri i fatkeqësive ka shënuar një trend në rritje ndër vite në periudhën 1999÷2014, duke filluar me pasqyrimin e zjarreve pyjore, si më poshtë.




DIAGRAMI 1. Trendet kohore të zjarreve pyjore në periudhën 1999÷2014 (DesInventar Kosova , 2015).

¹⁰ Agjencia e Menaxhimit Emergjent, 2015, DesInventarKosova, <http://desinventar.cimafoundation.org/DesInventar/profletab.jsp?countrycode=rks&continue=y>.




DIAGRAMI 2. Trendet kohore të vërshimeve dhe vërshimeve të shpejta për periudhën 1916÷2015.

Gjithashtu dhe për përmbytjet dhe vërshimet vërehet i njëjti trend ku fenomenet janë në rritje ndër vite. Thuajse 90% e 264 ngjarjeve totale që kanë ndodhur në vitet 2000÷2014. Në përgjithësi numri i ngjarjeve është në rritje duke arritur në vitin 2006 kuotën maksimale (68 ngjarje). Në 15 vitet e fundit të paktën një përmbytje ka ndodhur çdo vit në vendose në mesatare 18 ngjarje në vit.




DIAGRAMI 3: Trendet kohore për rrëshqitjet e dheut, periudha kohore: 2000-2014. Bazuar në historikun e fatkeqësive natyrore, rrëshqitjet e dheut kanë shënuar rritje graduale, sidomos në vitet 2012-2014, nga 2 ngjarje mesatarisht çdo vit.



DIAGRAMI 4. Trendet kohore tek tërmetet, periudha kohore: 1456-2014.

Tërmetet për periudhën 1851 ÷ 2013 gjithashtu reflektojnë trend në rritje në 20 vitet e fundit. Por kjo mund të jetë edhe si pasojë e mungesës së të dhënave para 1993 kur vetëm fatkeqësitë natyrore me përmasa të mëdha janë evidentuar.

Sa i përket termave financiare të dhënat nga fatkeqësitë në të shkuarën gjithashtu nga DesInventar pasqyrojnë një trend në rritje të dëmeve ekonomike që më 2000. Për shembull kjo reflektohet në grafikun e mëposhtëm për periudhën 2000-2014.



DIAGRAMI 5: Dëmet ekonomike (në EURO) nga vërshimet

2.4.3. Krahasimi me vendet rajonale

Kosova duke qenë një vend ende në tranzicion si pasojë e luftës 1998-1999 me zhvillim më të ulët ekonomik dhe social, ka më shumë sfida përse i përket ZRRF. Për dallim nga vendet në rajon si Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, Bosnja Hercegovina, Kosova ka ngritur institucione të reja shtetërore të cilat kryesisht vetëm gjatë fundit të viteve 2000 kanë nisur të prioritulojnë më shumë ZRRF. Në tërësi siç u përmend për shkak të zhvillimit të ulët ekonomik, shoqëror dhe mjedisor, rreziku nga fatkeqësitë natyrore për Kosovën është i konsiderueshëm për shkak të probabilitetit të lartë të prekshmërisë së popullatës.

2.4.4. Analiza e përparësive, dobësive, rreziqeve dhe mundësive

PËRPARËSITË:	DOBËSITË :
<ol style="list-style-type: none"> 1. Legjislacioni¹ në fuqi përcakton detyrat, përgjegjësitë, dhe mekanizmat e koordinimit institucional. 2. AME është institucion koordinues për FNFT në Kosovë. 3. Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës përfshin Deklaratën e Politikave Prioritare Afatmesme 2014-2016 . 4. Ekziston një spektër i gjerë i institucioneve qeveritare dhe joqeveritare që janë të kyçura dhe aktive në fushën e ZRRF-së. 5. Korrigjimi i programit dhe planit të aktiviteteve për ngritjen e vetëdijesimit në të dy nivelet e pushtetit për FNFT. 6. Ekzistojnë dokumente bazike kombëtare: Dokumenti për Vlerësimin e Rreziqeve nga FNFT (në nivel vendi dhe lokal) dhe Plani i Reagimit Kombëtar. 7. Institucionet publike dhe private të arsimit të lartë ofrojnë kurse të akredituara lidhur me ZRRF. 8. MASHT ka aprovuar Kornizën e Kurrikulës së Kosovës dhe Kurrikulat bërthamë. 9. Institucionet e Kosovës kanë zhvilluar aktivitete të ZRRF-së por që nuk kanë qenë të përkufizuara si të tilla. 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Sistemi i ZRRF duke përfshirë ligjet, politikat dhe rregulloret është ende i pakonsoliduar. 2. Institucionet e Kosovës kanë mungesë të kapaciteteve për ciklin e menaxhimit të fatkeqësive nga FNFT.² 3. Kosova ka më shumë mekanizma që fokusohen në menaxhimin emergjent nga FNFT përkundrejt parandalimit dhe zvogëlimit të tyre. 4. Zvogëlimi i Rrezikut nga fatkeqësitë nuk është i përfshirë mjaftueshëm në planet dhe politikat e qeverisë. 5. Mungojnë mekanizmat e qartë të përgjegjësisë dhe llogaridhënies për zbatimin e ligjeve dhe politikave që lidhen me ZRRF-të. 6. ZRRF ende nuk është prioritet i qeverisë për ndarjen e mjeteve të nevojshme nga buxheti kombëtar duke përfshirë parandalimin, gatishmërinë, reagimin dhe rimëkëmbjen. 7. Mungojnë kapacitetet teknike dhe organizative për menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe të tjera përfshirë sistemin e paralajmërimit dhe gatishmërisë të hershëm. 8. Koordinimi ndër-institucional për ZRRF është ende në hapat e para të tij. 9. Statistika dhe baza e të dhënave për ZRRF është shumë e limituar. 10. Mosqasja në të dhëna në kohë reale dhe duke përfshirë lokacionin dhe të dhëna hapësinore sikurse janë sistemet me teknologji gjeografike (GIS) për ZRRF. 11. Implementimi i pakët i aktiviteteve në ndërgjegjësimin dhe vetëdijesimin e komuniteteve për krijimin e një komuniteti të sigurt dhe të qëndrueshëm. 12. Njohuritë dhe praktikat tradicionale nuk janë integruar mjaftueshëm në sistemin e ZRRF.

MUNDËSITË	RREZIQET
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kosova synon të implementojë Kornizën Senday për Veprim (2015-2030). 2. Ekziston marrëveshja bilaterale për mbështetje me Turqinë, Kroacinë, si dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me Maqedoninë dhe Shqipërinë. 3. Sistemi i inventarit historik të fatkeqësive, (DesInventar) me qëllim të hartimit të politikave dhe të planeve në vazhdimësi. 4. Plotësimi i kornizës së tanishme juridike me përfshirje më të gjërë të ciklit të menaxhimit emergjent: parandalimi, gatishmëria, reagimi dhe rimëkëmbja. 5. Përfshirja e vlerësimit të rrezikut në planet zhvillimore. 6. Zhvillimi dhe koordinimi i sistemit të hershëm të lajmërimit dhe paralajmërimit të hershëm në të gjitha nivelet e pushtetit. 7. Përfshirja e Euro-kodeve dhe mikrozonimin sizmik, si dhe hulumtimeve shkencore në planet zhvillimore (hapësinore, urbanistike, infrastrukturore etj). 8. Prezenca e organizatave ndërkombëtare paraqet një mundësi të mirë për mbështetje për implementimin e kësaj strategjie. 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Niveli i ulët i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror është një nga indikatorët që fatkeqësitë në Kosovë të kenë pasojë të konsiderueshme. 2. Financimi i pamjaftueshëm për ZRrF në programet e qeverisë dhe donatorëve të huaj. 3. Kosova nuk është anëtare e OKB-së dhe mekanizmave relevantë ndërkombëtarë qëndikojnë në mungesë të fondeve dhe mjeteve të përfituara nga grante të ndryshme të programeve ndërkombëtare për ndërtimin e kapaciteteve për ZRrF. 4. Infrastruktura ndërtimore dhe trajtimi i baseneve të lumenjve si pasojë e mungesës së planeve urbanistike dhe projekteve konkrete, nuk plotëson kriteret e ZRrF-së. 5. Mosimplementimi i dispozitave ligjore në fuqi ngrit rrezikshmërinë nga FNFT. 6. Mbingarkimi i mekanizmave koordinuese ndërinstitucionale me formalitete burokratike dhe administrative, që do të ngadalësonin rrjedhën e informacionit dhe vendimmarrjen. 7. Listimi i rreziqeve të reja është sfidë në vazhdimësi. 8. Mosimplementimi i strategjisë në tërësinë territoriale të Kosovës.

Kjo Strategji në veçanti adreson këto probleme që lidhen me kapacitetin e Kosovës për tu përballë më fatkeqësitë natyrore:

- Mungon përfshirja e zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë në politika dhe plane zhvillimore.¹¹
- Kapacitetet e institucioneve qeveritare në paralajmërim të hershëm kanë nevojë për ngritje dhe fuqizim.¹²
- Nevoja e hartimit, zhvillimit të programeve dhe trajnimeve për krijimin e **komuniteteve të sigurta dhe të qëndrueshme nga fatkeqësitë.**
- **Listimi i rreziqeve të reja**, analizimi dhe masat parandaluese janë sfidë në vazhdimësi për realizimin e suksesshëm të kësaj strategjie.

¹¹ Zupka, 2014. Integrimi i Zvogëlimit të Rrezikut për Investime.

¹² Qeveria e Kosovës, 2014, Analiza e Sektorit Strategjik të Sigurisë.

2.4.5. Adresimi nga Qeveria

Qeveria e Kosovës zotohet që do të ndërmarrë gjithë masat e nevojshme për të adresuar problemet e përmendura më sipër, duke llogaritur edhe mbështetjen e partnerëve strategjik ndërkombëtarë sikurse janë organizatat nga: Kombet e Bashkuara, Bashkimi Evropian, bashkëpunimet dypalëshe dhe shumë-palëshe, si dhe donacionet.

2.4.6. Aktivitetet ekzistuese dhe të planifikuara

Agjencia e Menaxhimit Emergjent si institucion koordinues për ZRRF ka zhvilluar disa aktivitete në këtë fushë me agjencitë të cilat planifikohen të vazhdojnë edhe në periudhën që mbulon kjo strategji, sikur që janë:

Sistemi i paralajmërimit të hershëm

AME në bashkëpunim me Institutin Hidrometeorologjik të Kosovës (IHMK) dhe Shërbimin Gjeologjik të Kosovës/ Divizioni Sizmik, institucione përgjegjëse për monitorimin dhe paralajmërimin e hershëm të dukurive natyrore që shkaktojnë fatkeqësi natyrore, do të krijojë një sistem efikas të komunikimit elektronik në mes të këtyre dy instituteve dhe AME, për paralajmërimin e hershëm të fatkeqësive natyrore, në mënyrë që t'i shërbejë AME-së për hartimin e planit dhe aktiviteteve për parandalimin apo zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore, në rastet kur këto fatkeqësi paralajmërohen nga institucionet përgjegjëse.

Krijimi i historikut të të dhënave për fatkeqësitë natyrore- DesInventar

AME në bashkëpunim me organizatat e OKB-së (UNDP dhe UNISDR) ka krijuar databazën e parë historike të Kosovës të fatkeqësive natyrore -DesInventar, e cila do të jetë pikënisje për analizimin e faktorëve kyç dhe do t'i shërbejë institucioneve qeveritare dhe hulumtuesve shkencorë për hartimin e planeve dhe masave parandaluese për ZRRF-në.

Komunikimi publik dhe vetëdijesimi i qytetarëve për ZRRF

Institucionet qendrore mbështesin qeverisjen lokale dhe komunitetet në zhvillimin dhe zbatimin e planeve për zvogëlimin e rreziqeve, mekanizmat e reagimit, trajnimin e ekipeve reaguese në komunitet dhe hartëzimin e rreziqeve. AME në vazhdimësi plotëson me të dhëna të reja DesInventarin nga institucionet qeveritare dhe lokale dhe informon publikun duke freskuar vazhdimisht veb-faqen e saj (<http://ame.rks-gov.net/>) me informacionet më të fundit për ngjarjet dhe efektet emergjente në vend.

Adresimi i faktorëve të rrezikut.

Në frymën e Kornizës së Senday-it, AME bën koordinimin e mekanizmave relevant shumë-sektorial kundrejt rreziqeve nga FNFTnë Kosovë nëpërmjet Këshillit Ndërmnistror dhe Sekretariatit për monitorimin e zhvillimit të strategjisë dhe planit të veprimit.

Ngritja e kapaciteteve humane

AME në vazhdimësi nëpërmjet trajnimeve dhe kurseve mbështet akterët kryesorë nga institucionet relevante qendrore dhe lokale që kanë përgjegjësi dhe detyra në fushën e menaxhimit emergjent.

Bashkëpunimi ndërkombëtar

AME është pjesëmarrëse e projekteve ndërkombëtare:

- Ndërtimi i fleksibilitetit ndaj fatkeqësive në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi¹³ përfshirë mbështetjen për ndërtimin e kapaciteteve rajonale në fushën e bashkëpunimit ndërkufitar dhe ndërrajonal, si edhe këmbimi i informacioneve.
- Programi BE-së për Mbrojtjen Civile (IPA)¹⁴ që ka për qëllim ofrimin/shkëmbimin praktikave të mira nga vendet BE-së dhe rajonit për sistemin e paralajmërimit të hershëm, monitorimin, mbështetjen e vendeve nikoqire dhe qendrat operative emergjente-112.
- UNDP /OKB është e përkushtuar që përmes projektit: Iniciativa Kosovare për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë dhe projekteve të tjera në të ardhmen të vazhdojë mbështetjen dhe forcimin e kapaciteteve të qeverisjes në nivel qendror e lokal sipas nevojave.
- Komisioni Evropian përmes IPA programit (Mbrojtja Civile II dhe Përmbytjet) në vazhdimësi do të mbështesë qeverinë e Kosovës në menaxhimin efektiv të fatkeqësive duke këmbyer përvojat me shtetet fqinje dhe përmes ushtrimeve praktike fushore në tavolinë.
- Federata e Kryqit të Kuq do të mbështesë komunitetin duke ndihmuar me: reagim ndaj fatkeqësive, monitorim dhe raportim përmes vullnetarëve të saj.
- Organizatat ndërkombëtare: UNICEF, Save the Children dhe UNDP do të vazhdojnë mbështetjen përmes programeve në shkolla dhe aktiviteteve të tjera në institucionet arsimore për realizimin e ZRRF-së.

¹³ UNISDR, Preventionweb, <http://www.preventionweb.net/ipadrr/>, qasja më 11 Dhjetor 2015

¹⁴ Bashkimi Evropian, Programi I Instrumenti Evropian I Bashkëpunimit për Mbrojtjen Civile për vendet candidate dhe ato potencialisht candidate, <http://www.ipacivilprotection.eu/index.html>, qasja më 11 Dhjetor 2015

KAPITULLI III:

KUADRI STRATEGJIK

VIZIONI – zhvillimi i sistemit të frytshëm, efektshëm dhe gjithëpërfshirës për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe teknologjike, sistem të integruar të menaxhimit emergjent i cili do të kontribuoj në rritjen e sigurisë dhe zhvillimin e qëndrueshëm në vend.

MISIONI - Zhvillimin e sistemit të integruar për mbrojtje dhe shpëtim, krijimin e kushteve për ndërtim të shoqërisë së qëndrueshme për përballimin e fatkeqësive natyrore dhe teknologjike në Republikën e Kosovës.

QËLLIMI - i Strategjisë është të kontribuojë në arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm, integrimin e zvogëlimin të rrezikut nga fatkeqësitë në planet dhe politikat zhvillimore dhe ngritja e kapaciteteve të komunitetit për përballje me fatkeqësitë.

FOKUSI: Strategjia përqëndrohet në fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësi të tjera duke përfshirë fatkeqësitë teknologjike që prekin Kosovën. Një listë e plotë e këtyre rreziqeve janë të përfshira në Dokumentin e Vlerësimit të Rrezikut¹⁵, hartuar në 2009 dhe rishikuar në 2016. Sa i përket infrastrukturës kritike dhe rreziqeve të tjera të sigurisë këto do të trajtohen në legjislacion tjetër¹⁶ i cili është duke u hartuar aktualisht dhe për këtë nuk është i përfshirë në strategji

3.1. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE DHE MASAT E NDËRMARRA

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

1. Integrimi i zvogëlimit të rrezikut në politika dhe plane zhvillimore si dhe mbikëqyrja

Mungon një mjedis i përshtatshëm pasi: mekanizmat për fatkeqësitë kanë nevojë të forcohen, sidomos ato për ZRrF, angazhimi politik i institucioneve është i ulët po ashtu edhe buxheti për ZRrF mungon, institucionet nuk kanë kapacitete specifike për FNFT dhe ligjet e strategjitë nuk shoqërohen sa duhet me mekanizma monitorimi.

Strategjia për Zvogëlimin e Rreziqeve nga Fatkeqësitë përcakton vullnetin e Institucioneve të Republikës së Kosovës për bashkëpunim, bashkërendim dhe qasje të unifikuar të institucioneve

¹⁵ Vlerësimi i Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësi të Tjera.

¹⁶ Qeveria e Kosovës, 2016, Draft Ligj Për Infrastrukturën Kritike dhe Mbrojtjen e saj.

qendrore, lokale dhe partneritetit ndërkombëtarë për tu ballafaquar me fatkeqësitë natyrore dhe ato tekniko-teknologjike, si dhe sfidat si pasojë e tyre.

Zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë nuk është shkencë në vete por ai është ngushtë i lidhur me të gjitha politikat dhe proceset zhvillimore të një shteti. Zhvillimi i politikave dhe planeve zhvillimore si në nivel qendror ashtu edhe në nivel lokal duke marrë në konsideratë edhe rolin e sektorit privat dhe të shoqërisë civile, kërkon përfshirje shumë-dimensionale dhe adekuate në fushën e zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë, posaçërisht në fushën e planifikimit hapësinor, planeve zhvillimore, zbatimin e kodeve të ndërtimit, adaptimit klimatik, shëndetësisë, infrastrukturës, bujqësisë dhe pylltarisë, edukimit, etj. Duke përfshirë integrimin e politikave dhe planeve nga ministritë e linjës në nivel më të lartë për ZRRF në harmoni me standardet ndërkombëtare.

2. Fuqizimi i kapaciteteve për menaxhimin e rreziqeve nga FNFT

Qeverisja e rrezikut sipas kornizës Senday¹⁷ duhet të ndërtohet në kuptimin e rrezikut nga fatkeqësitë duke përfshirë aspektet e rrezikut, cënueshmërisë dhe ndërtimin e kapaciteteve.

Duke iu referuar analizës SWOT, të kuptuarit e rrezikut për fenomenet e FNFT-së mbetet i pamjaftueshëm për institucionet e Kosovës sidomos përtej reagimit emergjent. Gjithashtu mungon mbështetja dhe sensi i të kuptuarit që FNFT-të duhet të jenë prioritet për zhvillim të kapaciteteve duke i lënë me pak mbështetje financiare e humane. Rreziqet e reja gjithashtu nuk analizohen sa duhet dhe vlerësimi i rreziqeve nga FNFT-të në plane komunale nuk realizohet sipas standardeve, prandaj është me rëndësi ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe teknike, si dhe përcaktimi i qartë i roleve dhe përgjegjësi për sistemin e ZRRF.

Fuqizimi i sistemit të ZRRF kërkon investime në kapacitete shkencore, teknike dhe të trajtohet si komponent thelbësor për zhvillim ekonomik dhe social për të prodhuar efekte të nevojshme me informata paralajmëruese të regjistruara, hulumtuara, parashikuara, analizuara dhe të modeluara për fatkeqësitë që mund t'i kanosen vendit, është e një rëndësie të veçantë që institutet shkencore që merren me monitorim, përpunim dhe hulumtim të shkaktarëve të fatkeqësive natyrore, të mundësojnë një parandalim të efektshëm dhe dëme sa më të vogla nga fatkeqësitë natyrore.

Sistemi i ZRRF-së të fuqizohet në aspektin e monitorimit, vlerësimit dhe promovimit të të dhënave për rreziqet/fatkeqësitë në mënyrë gjithëpërfshirëse të cilat do të mundësojnë hulumtimet e mëtejshme dhe zhvillimin e sistemit.

3. Krijimi i komuniteteve të sigurt dhe të qëndrueshme nga fatkeqësitë

Fatkeqësitë marrin përmasa më të mëdha në komunitete të papërgatitura për t'u ballafaquar me fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi tjera. Për të pasur një komunitet të sigurt dhe të qëndrueshëm nga fatkeqësitë, duhet ngritur nivelin e ndërgjegjësimit institucional dhe shoqëror me qasje programore afatgjata vetëdijësuese dhe investime konkrete në shumë fusha siç janë: arsimit dhe kurrikulat shkollorë, menaxhimi i fatkeqësive në komunitet, si dhe shfrytëzimin e njohurive dhe hulumtimeve për të ndërtuar një shoqëri të qëndrueshme.

¹⁷ Kombet e Bashkuara, 2015, Korniza Sendai për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë 2015-2030., <http://www.unisdr.org/inform/publications/43291>, qasja më 11 Dhjetor 2015.

Duke pas parasysh aspektin social, gjinor, ekonomik dhe diversitetin kulturor në Kosovë, rëndësi të veçantë duhet t'iu kushtohet komuniteteve më të cenueshme siç janë: personat me aftësi të kufizuara, komuniteteve të cilat jetojnë në varfëri të skajshme, komuniteteve të përqëndruara në zonat e rrezikuara nga fatkeqësitë natyrore si dhe hartimit të planeve dhe programeve me qëllim të edukimit, arsimimit dhe sensibilizimit të komunitetit e në veçanti fëmijëve dhe brezit të ri. Zbërthimi i detajuar i këtyre planeve, programeve dhe zbatimi pragmatik, praktik dhe me kujdes e përkushtim institucional, në nivelin qendror dhe lokal, përcjellur me një fushatë sensibilizuese dhe informuese, përmes portaleve, medimeve, fletushkave, radios, gazetave, rrjeteve sociale etj., mundëson krijimin e një komuniteti të sigurt dhe rezistentë por të qëndrueshëm, ndaj fatkeqësive.

4. Vetëdijësimi dhe nxitja e institucioneve dhe subjekteve për rreziqet nga FNFT

Kosova si shtet i ri dhe në zhvillim, me institucione dhe sisteme të reja dhe disa nga to me brishtësi të theksuar por me synim të qartë për fuqizim dhe funksionalizim të qëndrueshëm, me premisa dhe mundësi për një zhvillim të hovshëm në shumë sfera, ballafaqohet me sfida dhe të papritura si në aspektin e fatkeqësive natyrore ashtu edhe atyre tekniko-teknologjike.

Vetëdijësimi dhe nxitja e institucioneve dhe mekanizmave institucional përmes rregullativës ligjore, stimulimit dhe shtytjes së inovacioneve, hulumtimeve dhe punimeve shkencore, sigurimit dhe alokimit të burimeve të nevojshme financiare e logjistike, si dhe ndërmarrja e masave strukturore dhe jo-strukturore për menaxhim më të mirë të rreziqeve.

Promovimi i protokolleve, këmbimi i informacioneve dhe bashkëpunimi rajonal për lehtësimin e shkëmbimit të kapaciteteve, si dhe krijimi i lehtësirave për reagim emergjent gjatë dhe pas fatkeqësive.

Inkurajimi i politikave dhe programeve që adresojnë zhvillimin e standardeve, planeve, projekteve konkrete, mobilitetin njerëzor dhe material për ngritjen e SMSHn, si dhe trajnimin-aftësimin e tyre. Promovimi i mobilizimit, organizimit, certifikimit dhe strukturimit të sektorit privat, shoqërisë civile, organizatave dhe shoqatave të ndryshme për mbështetje profesionale në lëmin e kërkim-shpëtimit, shëndetësisë, etj.

Migrimi i popullatës me theks të veçantë zgjerimi dhe mbi-popullimi i qyteteve si dhe zhvillimet e hovshme tekniko-teknologjike, mund të sjellin në të ardhmen fenomene të reja dhe fatkeqësi natyrore dhe teknologjike të cilat do të paraqesin rreziqe dhe fatkeqësi për Kosovën.

Eksplorimi i metodave dhe programeve më të avancuara nga vendet me përvojë dhe me sisteme më të zhvilluara, kërkon një koordinim, shkëmbim të informatave dhe një përfshirje të mekanizmave të nevojshëm të institucioneve, si dhe shkrirja e këtyre përvojave dhe ekspertizave në plane të detajuara me qëllim të arritjes së efekteve për zvogëlimin e rreziqeve që vijnë nga zhvillimi i hovshëm si pasojë e globalizimit, zhvillimit të hovshëm ekonomik, migrimëve, epidemive dhe ndryshimeve klimatike.

MASA PËR T'U NDËRMARRË

1. Integrimi i zvogëlimit të rrezikut në politika dhe plane zhvillimore si dhe mbikëqyrja

- 1.1. Integrimi i politikave për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë, si dhe zbatimimi i ligjshmërisë me qëllim të menaxhimit dhe qeverisjes së rreziqeve;
- 1.2. Forcimi i mekanizmave institucional dhe kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse në nivel qendror dhe lokal për zbatimin e strategjisë;
- 1.3. Lobimi për angazhimin politik si dhe marrja e përgjegjësisë dhe llogaridhënia;
- 1.4. Rritja e mbështetjes financiare për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë;
- 1.5. Harmonizimi i ligjeve/politikave sektorale me standartet e vlerësimit dhe menaxhimit të rreziqeve;
- 1.6. Formimi i një trupi mbikëqyrës për zbatimin e Strategjisë për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë.

2. Fuqizim i kapaciteteve për menaxhimin e rreziqeve nga FNFT

- 2.1. Rritja e aftësive për gjenerimin e informacioneve (statistikave dhe të dhënave të ndryshme) për FNFT;
- 2.2. Forcimi i kapaciteteve përgrumbullimin, vlerësimin dhe analizimin e informatave, si dhe plotësimi i vazhdueshëm i bazës së të dhënave për fatkeqësitë natyrore, Des-Inventar-it;
- 2.3. Zgjerimi i kapaciteteve të reja të institucioneve në nivel qendror dhe lokal për sistemin e paralajmërimit të hershëm;
- 2.4. Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit ndër-institucional për paralajmërimin e hershëm në lidhje me zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore;
- 2.5. Mbështetja e hulumtimeve, këmbimit të informacioneve dhe bashkëpunimit me institucione shkencore dhe akademike me qëllim të zvogëlimin të rreziqeve ekzistuese dhe parandalimi i rreziqeve të reja;
- 2.6. Të kuptuarit e rrezikut nga fatkeqësitë dhe dimensionet e tij.

3. Krijimi i komuniteteve të sigurta dhe të qëndrueshme nga fatkeqësitë

- 3.1. Përmirësimi i komunikimit dhe shpërndarjes së informacioneve në mes institucioneve përkatëse për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore;
- 3.2. Përfshirja e njohurive për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë në kurrikulën arsimore;
- 3.3. Vetëdijësimi dhe sensibilizimi i komunitetit përrëndësinë e zvogëlimin të rrezikut nga fatkeqësitë natyrore përmes fushatave mediatike, rrjeteve sociale, trajnimeve, ushtrimeve si dhe masavembrojtëse;
- 3.4. Organizimi dhe ngritja e strukturave për mbrojtje-shpëtim dhe ndihmë (SMSHN);
- 3.5. Përfshirja dhe organizimi i të rinjve dhe shoqërisë civile në SMSHN me qëllim të zvogëlimin të rrezikut nga fatkeqësitë natyrore;
- 3.6. Përfshirja e komunitetit të cenuar (gratë shtatzëna, fëmijë, të moshuar, persona me sëmundje kronike, persona me aftësi të kufizuara, etj) në hartimin e planeve për menaxhimin e rreziqeve.

4. Vetëdijësimi dhe nxitja e institucioneve dhe subjekteve për rreziqet nga FNFT

- 4.1. Promovimi dhe zhvillimi i instrumenteve dhe programeve që hartojnë standarde, kode, udhëzime operacionale, plane, projekte, etj;
- 4.2. Përmirësimi i komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit mes institucioneve relevante në identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve;
- 4.3. Thellimi i integritit të strategjisë dhe koordinimi i aktiviteteve të institucioneve relevante në procesin e identifikimit të rrezikut, vlerësimit dhe ndërmarrja e masave mbrojtëse;
- 4.4. Zhvillimi i standardeve të cilësisë të tilla si certifikimi dhe mirënjohja për menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë me pjesëmarrjen e sektorit privat, shoqërisë civile, organizatave dhe shoqatave dhe organizatave;
- 4.5. Promovimi dhe mbështetja emarrëveshjeve për bashkëpunim rajonal dhe ndërkombëtar;
- 4.6. Sigurimi i informacionit cilësor, vlerësimi, krijimi i statistikave/databazave si dhe monitorimi i trendeve për rreziqet e reja nga fatkeqësitë natyrore;
- 4.7. Promovimi i protokolleve rajonale për lehtësimin e shkëmbimit të kapaciteteve dhe krijimin e lehtësirave për reagim emergjent gjatë dhe pas fatkeqësive.

KAPITULLI IV:

ALTERNATIVAT E KONSIDERUARA

Kjo Strategji është bazuar në praktikat më të mira rajonale dhe ndërkombëtare të cilat adresojnë problematika të ngjashme në fushën e ZRRF-së:

- Strategjia Kombëtare për Reduktimin e Rrezikut ndaj Fatkeqësive dhe Mbrojtja Civile 2014-2018, Republika e Shqipërisë;
- Strategjia e Kroacisë për SZRRF, strategji kjo e cila është e bazuar mbi hulumtime shkencore;
- Strategjia e Maqedonisë për SZRRF;
- Platforma Kombëtare për Fatkeqësitë Natyrore: PLANAT;
- Strategjia Evropiane për Mbështetjen e Zvogëlimit të Rrezikut nga Fatkeqësitë në vendet në Zhvillim (2009).

Pasi mori në konsideratë **këto** modele, Kosova vendosi të bazohet në modelin Zvicëran, **për** një strategji e cila ndërtohet mbi kontekstin e saj specifik si edhe në përputhje me Kornizën e Senday-it dhe Strategjinë Evropiane. Modeli kryesor bazohet në grupin e punës ndërministror i cili hap pas hapi hartoi këtë strategji.

KAPITULLI V:

KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE

Dokumenti ka shqyrtuar dhe është në linjë me planet dhe strategjitë kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e mjedisit siç janë: Strategjia për Ndryshime Klimatike e Kosovës (2014-2024); Strategjia e Ujërave të Kosovës; Dokumenti bazik i Republikës së Kosovës: SIME, Strategjia për Siguri, Synimet e Mileniumit për Zhvillim dhe Korniza e Senday-it për Veprim (2015-2030). Gjithashtu, kjo strategji bazohet në mekanizmat Evropianë siç janë: Strategjia e Unionit Evropian për Sigurinë e Brendshme dhe Strategjia Evropiane për Mbështetje në Zvogëlimin e Rreziqeve për FNFT të vendeve në zhvillim.¹⁸

Strategjia për ZRRF bazohet kryesisht nga Ligji nr. 04/-L-027 për FNFT si dhe në Dokumentine Vlerësim-it të Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore, (i aprovuar në vitin 2009 dhe i rishikuar në vitin 2015). Grupi punues ndërministror gjatë hartimit të kësaj strategjie ka konsultuar edhe ligje tjera që kanë relevancë apo ngërthejnë në vete trajtimin apo rregullimin e fushës së ZRRF-së në mënyrë direkte apo indirekte si:

- Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit nr. 2009/03-L-025 ;
- Ligjin për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, nr. 2010/03-L-214;
- Ligji për Mbrojtjen nga Zjarri, nr. 2011/04-L-012;
- Ligjin për Këshillin e Sigurisë së Kosovës, nr. 2008/03-L-050;
- Ligjin për Menaxhimin Publik Financiar, nr. 2013/04-L-194;
- Ligjin për Ministrinë e Forcës të Sigurisë së Kosovës, nr. 2008/03-L-045;
- Ligjin për Policinë, nr. 2011/04-L-076;
- Ligjin për Shëndetin Publik, nr. 2007/02-L-78;
- Ligjin për Shërbimin Shëndetësor Emergjent, nr. 2006/02-L-50;
- Ligjin për Kryqin e Kuq të Kosovës, nr. 2010/03-L-179 ;
- Ligjin për Qeverisjen Lokale, nr. 2008/03-L-040;
- Ligjin për Planifikimin Hapësinor nr. 2012/04-L-174;
- Ligjin nr. 04/I-188 Për Trajtimin e Ndërtimeve Pa Leje;
- Ligjin për Ndërtim nr. 04/L-110,
- Ligjin nr. 2003/3 Për Pyjet e Kosovës,
- Ligjin për Mjedisin Nr. 03/L-02 , dhe
- Ligjin për Ujërat e Kosovës Nr 2004/24.

Strategjia kontribuon drejtpërdrejtë në menaxhim të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësitë e tjera¹⁹ si pjesë e Planit të Qeverisjenë veçanti në objektivin “ Kryerja e studimeve të veçanta me qëllim të parandalimit të emergjencave nga fatkeqësitë natyrore, si dhe përgatitja dhe përsosja e mënyrës së reagimit të kapaciteteve civile.”

Gjithashtu, qeveria ka hartuar Deklaratën e Politikave Prioritare Afatmesme 2014-2016 ku përmendet si prioritet menaxhimi i situatave emergjente.

¹⁸ UNISDR, Preventionweb, <http://www.preventionweb.net/ipadrr/>, qasja më 11 Dhjetor 2015

¹⁹ Qeveria e Kosovës, Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2015-2018, http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/programi_i_qeverise_shqip_pdf, qasja më Dhjetor 2015

Do të vazhdohet me politikat ekzistuese:

- Ngritjen e aftësisë vepruese;
- Kompletimi i infrastrukturës me mjete dhe pajisje të nevojshme, si dhe ndërtimi i objekteve për NJPZSH;
- Mbështetje të operacioneve të menaxhimit të situatave të prishjes së rendit dhe trazirave publike;
- Vazhdimin e bashkëpunimit me Programin IPA/ Komisioni Evropian për ngritjen e kapaciteteve;
- Themelimin e Qendrës Kombëtare për Menaxhimin e Situatave Emergjente;
- Zhvillimin e programit të ushtrimeve dhe vlerësimit të gatishmërisë emergjente në fushën e sigurisë së përgjithshme publike²⁰.

Rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve qendrore dhe pushtetit lokal nëZRRF

PUSHTETI QËNDROR

1. Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)

Bazuar në misionin dhe detyrat e MPB-së, roli i saj nëSZRRFështë ngritja e nivelit të sigurisë dhembrojtjae qytetarëve të Republikës së Kosovës,me theks të veçantë në fushën e menaxhimit emergjent nga FNFT.

2. Ministria e Financave (MF)

Ministria e Financave ka një rol thelbësor për zbatimin e efektshëm tëSZRRF. Analizon kërkesat buxhetore për zbatimin e SZRRF dhe në bashkëpunim me Këshillin Mbikqyrës bën aprovimin e buxhetit.

3. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)

Roli i MMPH bazuar në misionin dhe detyrat, padyshim se ka përgjegjësinë kryesore në realizimin e objektivave dhe masave të caktuara në SZRRF me rolin e saj mbikëqyrës dhe pjesëmarrjen aktive në monitorimin e strategjisë.

MMPH përmes SZRRF synon të zhvillojë politika integruese të shumë sektorëve të ndryshëm me qëllim të krijimit të kushteve për mbrojtjen e shëndetit dhe mjedisit nga FNFT në fushën e rrezatimit radioaktiv, ndërtimit, ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës, matjet e të reshurave atmosferike, ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, paralajmërimi i paraqitjes së fatkeqësive elementare hidrometeorologjike etj, si dhe ofron mbështetje shkencore dhe profesionale për politikat mjedisore të vendit.

4. Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE)

²⁰ Qeveria e Kosovës, 2013, Deklarata e Politikave Prioritare Afatmesme 2014-2016.

Roli i MZHE në zbatimin e SZRrF-së përfshin aktivitetet në: Sektorin e Energjisë dhe Minerave, Sektorin e Eficiencës së Energjisë dhe Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë, Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, Sektorin Postar, Sektorin e Telekomunikacionit, Sektorin e Teknologjisë Informative.

5. Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK)

Roli i FSK në implementimin e SZRrF përfshin tërë ciklin e menaxhimit të emergjencave por si objektiv primar i këtij subjekti është përcaktuar faza e gatishmërisë dhe reagimit, që të kryejë veprime operacionale në rastet e FNFTnë Kosovë dhe jashtë saj, sikur që janë: operacionet e mbrojtjes civile brenda Kosovës, të ndihmojë autoritetet civile në reagim ndaj FNFT. FSK ka rol të rëndësishëm në operacionet e kërkim shpëtimit, mënjanimin e mjeteve shpërthyes, kontrollin dhe pastrimin e materieve të rrezikshme, si dhe detyrat tjera të ndihmës humanitare.

6. Ministria e Integritit Evropian (MIE)

Roli i MIE-së në SZRrF përfshin mbështetjen për reforma në fushën e emergjencave civile të Kosovës në rrugën e saj drejt Bashkimit Evropian. Këtë rol e arrin duke harmonizuar politikat e Republikës me ato të BE-së, si dhe duke përafruar legjislacionin e saj me acquis të emergjencave civile të BE-së. Për më tepër MIE fasilton dhe përkrah bashkëpunimin në mes institucioneve vendore dhe Komisionin Evropian në arritjen e standardeve më të larta, njohurive, përgjegjësisë dhe transparencës në fushën e emergjencave civile.

7. Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ)

Roli i MPJ është promovimi dhe mbrojtja e politikave nacionale, kulturore e ekonomike të Kosovës në botë, zhvillimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe bashkëpunimi rajonal me interes të përbashkët, përmes marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe që përfshijnë edhe lëmin e menaxhimit të emergjencave, duke kontribuar në zvogëlimin e rreziqeve.

Kjo ministri është subjekti kryesor kontaktues për komunikim në rast të kërkesës për dhënie apo pranimin e ndihmës për mbështetjen e vendit të goditur nga FNFT por edhe për bashkëpunim ndërkombëtar në aktivitetet e tjera në lëmin e menaxhimit emergjent.

8. Ministria e Infrastrukturës (MI)

Roli i MI është zgjidhja teknike profesionale, zhvillimore dhe organizative për mirëmbajtjen, ndërtimin, rekonstruimin dhe sigurinë e hekurudhave, autostradës, rrugëve nacionale dhe rajonale, si dhe trafikut ajror. Me qëllim të zvogëlimin të rrezikut nga FNFT grumbullon të dhëna mbi trafikun dhe sigurinë, këshillon dhe njofton institucionet dhe qytetarët mbi gjendjen e rrjetit rrugor, hekurudhor dhe ajror, si dhe faktorët që ndikojnë në rrjetin e komunikacionit.

9. Ministria e Arësimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT)

Roli i MASHT, në harmoni me prioritetet kombëtare për zhvillim, është të siguroj një sistem cilësor të arsimit, që garanton sigurinë dhe mbrojtjen e nxënësve dhe stafit shkollor. Kjo do të realizohet duke krijuar mjedise të sigurta shkollore sipas parametrave dhe standardeve të nevojshme për zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitë. Duke përfshirë në kurrikulum përmbajtje që vetëdijesojnë

dhe aftësojnë nxënësit dhe të rinjtë në parandalimin dhe mbrojtjen nga fatkeqësitë. MASHT do të ketë rol të shtuar në përmbushjen e objektivave të SZRRF-së përmes ndërtimit të kapaciteteve në nivel qendror, lokal dhe shkollor në përgaditjen për parandalimin, reagimin dhe zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitë. Gjithashtu, MASHT në bashkëpunim dhe bashkërendim me akterët dhe institucionet tjera do të inkurajoj dhe përkrah simulimet e ndryshme që ndihmojnë nxënësit, të rinjtë, mësimmshënësist, stafin shkollor, por edhe prindërit dhe komunitetin të krijojnë shkathtësitë e nevojshme për t'u ballafaquar me situata të ndryshme të fatkeqësive. Kjo do të sigurojë një mjedis të sigurt, të shëndoshë e të qëndrueshëm.

10. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR)

Masat të cila duhet të ndërmerren MBPZH për arritjen e objektivave të SZRRF gjenden në politikën për të ndihmuar administrimin dhe menaxhimin e sektorit të pylltarisë, duke përfshirë edhe mbrojtjen, aktivitetet e ripyllëzimit, vetëmbajtjen, parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri, dezinfektimin kundër insekteve dhe sëmundjeve të ndryshme, licencimin për prerjen e drunjëve, kontrollimin e gjuetisë dhe peshkimit; ofron shërbime veterinarë, duke përfshirë ndër të tjera parandalimin e sëmundjeve të kafshëve, të zoonozës dhe përmirësimin e cilësisë së kopeve dhe tufave të shpezëve kurse në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor mbikëqyrë zbatimin e standardeve shëndetësore që ndërlidhen me bujqësinë, pylltarinë, zhvillimin rural, qendrat për rritjen e peshqëve, kontrollin e cilësisë së ushqimeve dhe të lëndëve të para bujqësore me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve.

11. Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK)

Roli i kësaj Ministrie për ZRRF është shumëdimensional por po vëmë në pah disa nga funksionet që i takojnë kësaj ministrie në bazë të detyrave dhe përgjegjësisë si dhe specifikave që ka:

- mbikëqyrë zbatimin e strategjisë brenda fushëveprimit të vet në nivel qendror dhe lokal i drejtohet komuniteteve për ndihmë, mbështet zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë në të gjitha komunat duke ndihmuar integrimin e politikave në planet e zvogëlimit të rreziqeve në kushte të barabarta të të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre;
- koordinon me ministritë, komunat dhe autoritetet e tjera për zbatimin e SZRRF gjithnjë bazuar në parimin e mbrojtjes dhe vetëmbrojtjes në FNFT duke respektuar të drejtat e njeriut, në mënyrë që të sigurojë promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pjesëtarëve të të gjitha komuniteteve, duke iu kushtuar vëmendje të posaçme nevojave të grave, fëmijëve, personave të moshuar dhe grupeve të tjera të ndjeshme;
- ndihmon në zhvillimin dhe në zbatimin e masave në fushën e informimit publik dhe të projekteve të tjera promovuese për ngritjen e vetëdijes publike përkitazi me të drejtat dhe interesat e komuniteteve e të pjesëtarëve të tyre për mbrojtje nga FNFT si dhe ndërmarrjen e masave për zvogëlimin e rrezikut nga FNT në bashkëpunim dhe inkurajim të sektorin privat dhe bizneset.

12. Ministria e Punës dhe Mirëqënies Sociale (MPMS)

Roli i Ministrisë së Punës dhe Mirëqënies Sociale në SZRRF realizohet me politikën, programet dhe dokumentet që gati mund të themi se janë detyrë e përkujdesit të përheshëm për ZRR ekonomike

dhe sociale e pse jo edhe të karakterit human. Forma e realizimit të tëZRRF janë: fuqizimi dhe krijimi i hapësirës për mirëqenie sociale, krijimi i infrastrukturës për punësim dhe aftësim profesional, që do të ngritë cilësinë në ofrimin e shërbimeve për të gjithë qytetarët në gjendje të nevojës sociale, gjithashtu ofron shërbime edhe për kategoritë e pensionistëve në kuadër të legjislacionit në fuqi, vazhdon përkushtimin ndaj qytetarëve me nevoja të veçanta pa dallime etnike, fetare, gjinore e racore, nga fëmijët e deri tek të moshuarit pa përkujdesje familjare.

MPMS vazhdon me ofrimin e shërbimeve për strehim familjar për fëmijë që nuk kanë lidhje farefisnore dhe realizimi i strehimit familjar të fëmijëve pa përkujdesje prindëror.

Siguron përkrahje financiare dhe sociale, emergjente dhe të përhershme, përmes institucioneve apo shërbimeve të ngritura për këtë qëllim për qytetarët me nevojë.

13. Ministria e Shëndetësisë (MSH)

Përcjell situatën e shëndetësisë dhe implementon masat adekuate për të parandaluar dhe kontrolluar problemet në lëmin e shëndetësisë duke përkrah pjesëmarrjen, iniciativat dhe zhvillimin e aktiviteteve të komunitetit që ndërlidhen me shëndetin dhe mbrojtjen e mjedisit. Merr pjesë në zhvillimin dhe implementimin e fushatës për informim publik dhe projekteve të tjera promovuese për të rritur vetëdijësimin publik në pajtueshmëri me standardet shëndetësore, inkurajon zhvillimin e arsimit shëndetësor dhe të mjedisit për të ngritjen e njohurive dhe kompetencave në lëmin e shëndetësisë dhe mbrojtjes së mjedisit. Monitoron dhe konstaton gjendjen e mjedisit, në veçanti ndikimin e veprimtarisë industriale, të shërbimeve publike dhe të veprimtarisë ekonomike, meqë ndërlidhen me mbrojtjen e mjedisit.

Në bashkëpunim me ministrinë tjera përkatëse, identifikon fushat që duhet mbrojtur për të mirën e popullatës, krijon politikën e aktiviteteve në sektorin e shëndetësisë për të promovuar zhvillimin koherent dhe implementimin e masave për ZRRF.

14. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MKRS)

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve rolin e saj në SZRRF e ka në ndërmarrjen e masave dhe zhvillimin e aktiviteteve në ruajtjen, mbrojtjen dhe prezantimin, restaurimin dhe konservimin e trashëgimisë kulturore, trashëgimisë arkitekturore, trashëgimisë së luajtshme, trashëgimisë shpirtërore, Konservimit të Integruar dhe peizazheve kulturore, si dhe inventarizimin dhe dokumentimin e trashëgimisë kulturore të Kosovës.

15. Ministria e Administratës Publike (MAP)

Krijimi i një administrate publike moderne, të qëndrueshme dhe të paanshme në shërbim të qytetarëve dhe bizneseve dhe ofrimi i shërbimeve cilësore administrative dhe infrastrukturë funksionale për institucionet qeverisjes.

16. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI)

Siguron mbështetje të drejtpërdrejt teknike dhe këshilla në prokurimin e shërbimeve konsultative të jashtme për vlerësimin e sigurisë strukturore dhe nga zjarri, të ndërtesave dhe linjave jetësore (shërbimet publike).

17. Ministria e Diasporës (MD)

Roli i Ministrisë së Diasporës në SZRrF është nxitja e bashkëpunimit shkencor, tekniko-teknologjik, shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira për ZRr nga FNFT të vendeve përkatëse. Krijimin e kushteve për investime kapitale të mërgimtarëve në vendlindje me qëllim të zvogëlimit dhe parandalimit të rreziqeve nga FNFT.

18. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL)

Roli i MAPL në SZRrF është mbështetja dhe avancimi i qeverisjes lokale në fuqizimin e strukturave për mbikëqyrjen e kësaj strategjie dhe sigurimin e zbatimit të aktiviteteve të planit të veprimit të cilat ndërlidhen me nivelin lokal.

Institucione dhe agjenci të tjera qendrore

Institucione dhe agjencitë e tjera qendrore kanë një rol të rëndësishëm në zbatimin e SZRrF bazuar në misionin, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në fushën e ZRrF.

Instituti Sizmologjik i Kosovës

Bazuar në misionin e tij Instituti Sizmologjik i Kosovës do të fokusohet në përmbushjen e objektivave përmes prioriteteve më poshtë:

1. Funksionimi efikas i Rrjetit Sizmologjik të Kosovës

- 1.1 Monitorimi në mënyrë të pandërprerë dhe me saktësi i ngjarjeve sizmike për territorin e Kosovës dhe me gjerë.
- 1.2. Njoftimi me urgjencë tek organet kompetente shtetërore, në rast se brenda territorit të Kosovës ndodhin tërmete me Magnitudë ≥ 3.5 .
- 1.3 Monitorimi mbi sizmicitetin, shkëputjet aktive dhe sizmo-tektonikën për territorin e Kosovës.

2. Analiza dhe studime të vulnerabilitetit dhe rrezikut sizmik

- 2.1. Studime Sizmologjike dhe Sizmo-tektonike për njohjen sa më të thellë të aktivitetit sizmik dhe sizmicitetit në Kosovë, si dhe vlerësimin e rrezikut sizmik.
- 2.2. Studime dhe vlerësime të rrezikut sizmik në nivel lokal për qendrat e banuara, informacione shumë të nevojshme për qëllime të planifikimit fizik dhe urban në zonat sizmike.
- 2.3. Përcaktimi i mekanizmit të vatrës, energjisë së liruar, tipit dhe kufirit të burimit sizmik në territorin e Kosovës.

3. Përpilimi i hartës së intensitetit maksimal për çdo vit

- 3.1. Futja e të gjitha ngjarjeve sizmike për territorin tonë në programin MapInfo dhe ndarja e sipërfaqes në çdo 5km² për vlerësimin e shpërndarjes së intensitetit maksimal, për magnituda më të mëdha se $M > 1$.
- 3.2 Implementimi i hartës të intensitetit maksimal dhe të epiqendrave të tërmeteve për çdo vit.

4. Shërbime sizmologjike me interes të veçantë shoqëror

- 4.1. Regjistrimi i tërmeteve dhe fenomeneve tjera sizmike të burimeve natyrore ose artificiale.
- 4.2. Vendosja, ruajtja dhe zhvillimi i rrjetit të stacioneve sizmologjike të monitorimit, përkatësisht rrjetit sizmografik dhe atij të lëkundjeve të forta.
- 4.3. Grumbullimi dhe analiza e të dhënave mbi tërmetet dhe fenomenet e tjera sizmike, shkaqet dhe pasojat e tyre.

Organizatat Jo Qeveritare dhe Vullnetare

Roli i OJQ-ve në SZRRF është mbështetja e institucioneve shtetërore duke ofruar ndihmë përmes fushatave ndërgjegjësuese dhe vetëdijësuese në ZRRF. Organizatat vullnetare ofrojnë kapacitetet e tyre duke ndihmuar ndjeshëm në menaxhimin e indienteve në të gjitha nivelet.

Pushteti lokal

Kryetarët e Komunave

- Themelon dhe mbikëqyrë grupin punues profesional për hartimin e Dokumentit Komunal për Vlerësimin e Rreziqeve nga FNFT dhe kujdeset për miratimin e tij.
- Emëron stafin e Komitetit për Mbrojtje dhe Shpëtim për raste emergjente.
- Themelon/Emëron grupin profesional punues dhe mbikëqyrës, për hartimin e planit hapësinor dhe urbanistik, duke hartuar dhe projekte konkrete si masa parandaluese.
- Mban përgjegjësi dhe detyra të tjera mbrojtëse për ndërmarrjen e masave konkrete në fushën e Menaxhimit Emergjent.

Kryqi i Kuq i Kosovës

Si e vetmja shoqatë kombëtare, Kryqi i Kuq operon sipas Ligjit për Kryqin e Kuq të Kosovës Nr 2010/03-L-179 dhe ndihmon autoritetet vendore për çështje humanitare në mbarë vendin. Punon me MFSK; AME/MPB; Entitetet tjera qeveritare qendrore, regjionale dhe lokale dhe OJQ-të tjera për të siguruar ndërgjegjësimin e popullatës dhe institucioneve qeveritare për ZRRF dhe koordinon integrimin e nevojave për ndihmë humanitare në raste emergjencash.

KAPITULLI VI:

MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Monitorimi dhe vlerësimi i strategjisë shoqërohet me indikatorë të matshëm konkretë dhe realistë të cilët janë në përputhje me standarde ndërkombëtare.

Për monitorimin e përmbushjes së objektivave të strategjisë formohet Këshilli Mbikëqyrës në nivel vendi, i cili do të jetë përgjegjës për realizimin e objektivave të strategjisë të institucioneve të nivelit qendror që synim kryesor ka zvogëlimin e rrezikut nga FNFT.

- Kryeministri i Qeverisë së Republikës së Kosovës/Ministri i MPB-së është autoriteti mbikëqyrës i Këshillit i cili kërkon përgjegjësi dhe ofron mbështetje institucionale dhe administrative.
- Këshilli Mbikëqyrës është autoriteti i vetëm për mbikëqyrjen e SZRRF-së në nivel të qeverisjes qendrore dhe lokale, i cili mbikëqyrë progresin e investimeve, punës dhe angazhimit gjithëpërfshirës drejt arritjes së objektivave dhe masave të strategjisë.
- Ministritë dhe agjencitë qendrore, përpilojnë raporte periodike mbi realizimin e planit të veprimit të ZRRF –së nën juridiksionin e tyre, si dhe adresojnë boshllëqet dhe sfidat nga fushëveprimtaria përkatëse tek Këshilli Mbikëqyrës.

Këshilli Komunal për SRrF i krijuar nga Kryetari i komunës merr detyra dhe përgjegjësi për monitorimin dhe zbatimin e strategjisë, për të gjitha aktivitetet, progresin, investimet drejt arritjes së objektivave dhe masave të strategjisë, këshillohet nga Këshilli Ndërmintor dhe njofton atë, bazuar në parimin e hierarkisë dhe subsidiaritetit.

Puna e Këshillit Mbikëqyrës do të udhëhiqet nga këto objektiva:

1. Krijimi i një mekanizmi të bashkëpunimit dhe koordinimit për ZRRF në nivel qendror dhe lokal, në sektorin privat, shoqërinë civile dhe donatorët ndërkombëtarë.
2. Mbështetja e institucioneve relevante të ZRRF-së në mbledhjen, përpunimin dhe shpërndarjen e informacioneve, si dhe në programet e vetëdijesimit, ngritjes së kapaciteteve, hulumtimeve shkencore si dhe menaxhimit efikas të njohurive.
3. Fuqizimi i aktiviteteve të cilat zvogëlojnë cenueshmërinë, ekspozimin ndaj FNFT dhe rrezikun nga gjenerimi i rreziqeve të reja.
4. Mbikëqyrë realizimin e përgjegjësive, llogaridhënies dhe aktiviteteve tjera të kësaj strategjie si dhe fuqizon zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë.

Përbërja e Këshillit Ndërmnistror

Për të siguruar një monitorim dhe zbatim efikas të kësaj strategjie nevojitet Këshilli Ndërmnistrorë në nivel strategjik/politik dhe sekretariati teknik - profesional.

Niveli strategjik-politik fillimisht propozohet të funksionalizohet në kuadër të Këshillit Ndërmnistror për Ujëra, i cili tashmë funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Ky këshill do të siguronte që vendimet që dalin nga kjo strategji të përcillen drejtpërdrejtë tek Kryeministri i Republikës së Kosovës.

- Këshilli për Ujëra të transformohet në një Këshill Ndërmnistror për : Ujëra, Zvogëlim të rreziqeve nga FNFT dhe Ndryshime Klimatike.
- Qeveria nxjerr vendim për përbërjen e re dhe përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit Ndërmnistror për: Ujëra, Zvogëlim të Rreziqeve nga FNFT dhe Ndryshime Klimatike.

Anëtarë të Këshillit propozohen të jenë:

- Kryeministri;
- Ministri i Punëve të Brendshme;
- Ministri i Administratës dhe Pushtetit Lokal;
- Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
- Ministria e Infrastrukturës;
- Ministri i Financave;
- Ministri i Zhvillimit Ekonomik;
- Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- Përfaqësues nga dy Komuna;
- Komuniteti i donatorëve, pa të drejtë vote.

Sekretariati i Këshillit

Sekretariati do të jetë strukturë e përhershme ekzistuese në kuadër të Këshillit i cili do të plotësohet edhe me staf profesional me nga një anëtarë nga ministritë përkatëse të Këshillit Ndërmnistror për Ujëra, zvogëlim të rreziqeve dhe ndryshime klimatike.

Propozim i grupi punues për SZRrF:

Kryesues i Sekretariatit të caktohet një anëtarë nga AME/MPB.

Autoriteti mbikëqyrës të nxjerr vendim për përbërjen e Sekretariatit.

Detyrat e Sekretariatit janë:

- Të koordinojë aktivitetet e institucioneve rreth zvogëlimit të rreziqeve;
- Të përgatit takimet e rregullta të Këshillit;
- Të finalizoj, shpërndaj dhe publikoj raportet e Këshillit tek Qeveria;

- Të organizoj konferenca, seminare, trajnime dhe punëtori në fushën e ZRrF-së, dhe
- Punë tjera të kërkuara nga Këshilli Mbikëqyrës.

7.3. Vlerësimi i kostos për zbatimin e Strategjisë për ZRrF

